



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

**DEPARTAMENTI PËR PLANIFIKIM DHE ANALIZA SOCIO-EKONOMIKE
RAJONALE**

**ANALIZË E ZHVILLIMIT SOCIO – EKONOMIK
RAJONAL TË BALANCUAR NË KOSOVË - VITI 2021**

Ky dokument është produkt i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, dhe i njëjti duhet të shërbej për nevojat e vet këtij institucioni, Ministrive të linjës dhe komunave të Republikës së Kosovës, lidhur me hartimin dhe zhvillimin e programeve të vazhdueshme për përkrahje të sektorit privat në Kosovë.

DOKUMENTI U HARTUA NGA:

Vjendita Avdiu - Musliu, zv.Drejtoreshë e Departamentit për Planifikim dhe Analiza Socio-Ekonomike Rajonale
Fatmire Thaçi, Udhëheqëse e Divizionit për Performancë Socio- Ekonomike Rajonale
Vlora Fetoshi, Zyrtare për Zhvillim Socio – Ekonomik
Blinda Bytyçi, Konsulente për Zhvillimi Socio-Ekonomik Rajonal të Balancuar

Përmbajtja:

I. Hyrje	5
II. Implementimi i programeve nga MZHR dhe Ministritë e linjës për përkrahje të sektorit privat – bizneseve në Kosovë, në vitin 2021	7
2.1 Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar PZHRB (2021), implementuar nga MZHR	8
2.2 Programi për Rimëkëmbje Ekonomike PRE-MASA 15, 2021 implementar nga MZHR	10
2.3 Programi për përkrahjen e NMVM-ve 2021 nga MINT	12
2.4 Programi për përkrahjen e granteve për vitin 2021 nga MBPZHR	12
III. Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar, PZHRB 2021.....	15
3.1 Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Qendër	15
3.2 Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Jug	20
3.3 Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Perëndim	24
3.4 Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Veri	28
3.5 Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Lindje	32
IV. Programi për Rimëkëmbje Ekonomike PRE-MASA 15, 2021	37
4.1 Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Qendër	37
4.2 Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Jug	42
4.3 Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Perëndim	46
4.4 Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Veri	50
4.5 Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Lindje	55
V. Paraqitja grafike e të dhënave rajonale (PZHRB DHE PRE-MASA 15), 2021.....	60
5.1 Rajoni Zhvillimor Qendër	61
5.2 Rajoni Zhvillimor Jug.....	61
5.3 Rajoni Zhvillimor Perëndim	62
5.4 Rajoni Zhvillimor Veri	63
5.5 Rajoni Zhvillimor Lindje.....	63
5.6 Paraqitja grafike dhe numerike e punësimit në kuadër të dy skemave të programeve për mbështetjen e sektorit privat.....	64
VI. Shuma e përgjithshme e investimeve në vlerë dhe (%), përfshirë lotet (Lot1-Start up, Lot1-Biznes ekzistues), në pesë (5) Rajonet Zhvillimore në Kosovë	65
6.1 Shuma e përgjithshme e investimeve në (%) sipas sektorëve në kuadër të programit mbështetës “PZHRB – 2021”	68
6.2 Paraqitja tabelare e shpërndarjes së projekteve sipas komuniteteve në rajone zhvillimore	69
6.3 Projektet përfituese nga gratë për vitin 2021, programi “PZHRB”	70
6.3.1 Shpërndarja tabelare e projekteve përfituese të udhëhequra nga gratë në pesë (5) rajone zhvillimore në Kosovë.....	70
6.3.2 Paraqitja grafike në % e shpërndarjes së tridhjetë e katër (34) projekteve të udhëhequra nga grate në pesë (5) rajonet zhvillimore në Kosovë.....	71
VII. Shuma e përgjithshme e investimeve në vlerë dhe (%), përfshirë lotet (Lot2 dhe Lot 3 - Biznese ekzistuese), në pesë (5) Rajonet Zhvillimore në Kosovë	72

7.1 Shuma e përgjithshme e investimeve në (%) sipas sektorëve në kuadër të programit mbështetës “MASA-15 - 2021”	75
7.2 Paraqitja tabelare e shpërndarjes së projekteve sipas komuniteteve në rajone zhvillimore	76
7.3. Projektet përfituese nga gratë për vitin 2021, programi “PRE-MASA-15”	77
7.3.1 Shpërndarja tabelare e projekteve përfituese të udhëhequra nga gratë në pesë (5) rajone zhvillimore në Kosovë.....	78
7.3.2 Paraqitja grafike në % e shpërndarjes së njëmbëdhjetë (11) projekteve të udhëhequra nga grate në pesë (5) rajonet zhvillimore në Kosovë.....	78
VIII. Përfundime dhe rekomandime	79
IX. Burimet e informacionit:	82

Lista e shkurtesave:

MZHR - Ministria e Zhvillimit Rajonal

MBPZHR - Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

MINT - Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

PZHRB - Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar

PRE MASA-15 - Programi për Rimëkëmbje Ekonomike

PZHR - Programi për Zhvillim Rajonal

AZHR - Agjensioni për Zhvillim Rajonal

RZHK - Rajonet Zhvillimore të Kosovës

RZHQ - Rajoni Zhvillimor Qendër

RZHL - Rajoni Zhvillimor Lindje

RZHJ - Rajoni Zhvillimor Jug

RZHV - Rajoni Zhvillimor Veri

RZHP - Rajoni Zhvillimor Perëndim

I. Hyrje

Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR), bazuar në mandatin e saj ligjor të përcaktuar me Shtojcën (15), të Rregullores (QR) Nr. 02/2021, për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 04/2021 për fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Planin e Punës për vitin 2022, ka përgatitur dokumentin analitik **“Analizë e Zhvillimit Socio – Ekonomik Rajonal të Balancuar në Kosovë”** për vitin 2021, duke përfshirë edhe **“Programin për Rimëkëmbje Ekonomike 2021 - Masa 15”**, të implementuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal gjatë vitit 2021.

Bazuar në mandatin e saj ligjor, MZHR zhvillon, menaxhon dhe promovon programe për të ofruar zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Synimi i përgjithshëm i MZHR-së përmes programeve të këtyre thirrjeve është zhvillimi socio-ekonomik rajonal i balancuar përmes zhvillimit të ndërmarrësisë në pesë rajonet zhvillimore të Kosovës. Zvogëlimi i papunësisë përmes krijimit të vendeve të reja të punës me theks të veçantë për të rinjtë, përkrahja e zhvillimit të bizneseve të reja dhe atyre me potencial rritjeje si dhe përkrahja e bizneseve që kontribuojnë në zëvendësimin e importeve, këto janë disa prej synimeve specifike që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik rajonal.

Në kuadër të mandatit të MZHR-së për përgatitjen e analizave lidhur me zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar kjo analizë trajton përkrahjen e MZHR-së dhe Ministrive tjera të linjës ndaj sektorit privat (bizneseve) e realizuar në vitin 2021. Këtu trajtohen gjerësisht programet (skemat) për dhënien e granteve të implementuara edhe nga Ministrinë tjera të linjës. Çështjet kryesore që e përbëjnë **“Analizën për Zhvillimin Socio-Ekonomik Rajonal të Balancuar në Kosovë për vitin 2021”** janë:

- Numri i aplikimeve të bizneseve sipas rajoneve zhvillimore dhe komunave;
- Numri i përfituesve (bizneseve) sipas rajoneve zhvillimore dhe komunave;
- Vlera financiare e financimit për bizneset përfituese;
- Vlera e bashkefinancimit nga bizneset përfituese;
- Sektorët përfitues më të financuar sipas rajoneve zhvillimore;
- Numri i vendeve të reja të punës të krijuara nga bizneset përfituese;
- Numri i përfituesve sipas Loteve të mbështetura nga Programet (PZHRB dhe PRE-MASA-15);
- Numri i përfituesve sipas përkatësisë etnike sipas rajoneve zhvillimore;

- Numri i përfituesve sipas gjinisë sipas rajoneve zhvillimore.

Përmes publikimit të kësaj analize, MZHR synon të vë në pah ndikimin e saj në zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar përmes financimit të projekteve ndërmjet pesë (5) rajoneve zhvillimore: rajonin Qendër, Veri, Jug, Lindje dhe Perëndim. Ajo pasqyron subvencionimin e bizneseve duke paraqitur zgjerimin e kapaciteteve të tyre pas implementimit të projekteve të tyre përfituese si: rritjen e qarkullimit, shtimin e kapaciteteve prodhuese dhe resurseve njerëzore, etj.

Gjatë vitit 2021, Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR), ka implementuar “Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar PZHRB 2021”, i cili është realizuar përmes Skemës së Granteve për mbështetje financiare ndaj bizneseve, si dhe “Programin për Rimëkëmbje Ekonomike 2021 - Masa 15”, program ky i implementuar në mbështetje të bizneseve ekzistuese për pesë rajonet zhvillimore të Kosovës të prekura nga pandemia COVID-19.

II. Implementimi i programeve nga MZHR dhe Ministritë e linjës për përkrahje të sektorit privat – bizneseve në Kosovë, në vitin 2021

Roli dhe fuqizimi i sektorit privat si promotor i zhvillimit ekonomik është shumë i rëndësishëm për ekonominë e tregut siç është rritja e produktivitetit, ruajtja e konkurrencës dhe sjellja e vlerës. Duke u bazuar në mandatin Ligjor dhe Buxhetin e aprovuar me Ligjin Vjetor të Buxhetit, disa prej Ministrive të Qeverisë së Republikës së Kosovës, zhvillojnë dhe realizojnë programe në përkrahje sektorit privat duke financuar kështu implementimin projekteve të këtyre bizneseve.

Rëndësi e veçantë i është kushtuar fuqizimit të bizneseve në sektorin e prodhimit, si faktor kyç i zhvillimit ekonomik, duke mundësuar hapjen e vendeve të reja të punës dhe duke ndikuar kështu në uljen e papunësisë. Bazuar në analizën tre vjeçare, në vitet (2018 – 2021), sektori më i financuar gjate këtyre tre viteve është sektori i prodhimit.

Viti 2021 është viti i katërt që Ministria e Zhvillimit Rajonal implementon programin për përkrahje të bizneseve, “Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB)”, si dhe për herë të dytë, “Programin për Rimëkëmbje Ekonomike 2021, Masa 15”, program ky i cili derivon nga Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2020-2023 i aprovuar në Qeveri ku me miratimin e Ligjit për Buxhetin 2021, është krijuar program i veçantë, Programi për Rimëkëmbje Ekonomike, ku janë alokuar mjetet që janë dedikuar për qëllime të mbështetjes ekonomike dhe sociale për të tejkaluar sfidat e pandemisë. Ministria e Zhvillimit Rajonal është përcaktuar përgjegjëse për zbatimin e “Pre-Masa-15”, për mbështetjen e programeve ekzistuese që lidhen me zhvillimin rajonal e që ndikojnë në zhvillimin rajonal të balancuar.

MZHR përveç përkrahjes së bizneseve në sektorin e prodhimit, gjithashtu ka përkrahur edhe sektorin e shërbimeve duke përfshirë dhe TI-në, konform buxhetit të aprovuar dhe të paraparë për realizimin e këtyre programeve.

Sipas raporteve përmbledhëse nga Departamenti për Zhvillim Rajonal (DZHR), për implementimin e këtyre programeve nga MZHR në të gjitha rajonet zhvillimore në programin PZHRB janë përkrahur **(84)** projekte dhe janë krijuar kushte për **(147)** vende të reja të punës. Gjithsej vlera totale financiare e projekteve të implementuara për **“PZHRB-2021”** është **396,221.62€**. Ndërkaq në programin **“PRE-MASA 15, 2021”** janë përkrahur **(80)** projekte dhe janë krijuar kushte për **(218)** vende të reja të punës. Vlera totale e projekteve të implementuara për këtë program është **980,057.00€**. Vlera e përgjithshme e financimit për projektet përfituese

të implementuara me sukses për dy programet, është gjithsej **(1,376,278.62)€**, të shpenzuara nga buxheti i MZHR-së, për vitin 2021.

Duke u bazuar në ngjashmërinë e programeve lidhur me kualifikueshmërinë e llojeve të bizneseve (mikro, të vogla dhe të mesme) dhe sektorëve (prodhim dhe shërbim) në të cilët janë përkrahur bizneset nga ministritë e linjës në vitin 2021, MZHR në vitin 2021, në këtë analizë ka shtjelluar edhe thirrjet për mbështetje të bizneseve të financuara nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, si dhe Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Më poshtë janë shtjelluar qëllimet e këtyre thirrjeve pasi që këto dy programe nuk kanë arritur të implementohen për vitin 2021. Ndërkaq programet e implementuara nga MZHR i gjeni të shtjelluara dhe të detajuara në pesë rajone zhvillimore.

Në këtë analizë trajtohen këto programe të realizuara për përkrahje të bizneseve:

1. Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB 2021) dhe (PRE-MASA 15); 2021), realizuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR);
2. Programi për përkrahjen e NMVM-ve, i realizuar nga KIESA/MINT, programi për përkrahjen e bizneseve fillestare i realizuar nga Departamenti i Inovacionit Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë MINT;
3. Programi për subvencionim nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Zgjerimi i kapaciteteve biznesore, gjenerimi i vendeve të reja të punës dhe rritja e eksportit zëvendësimi i importit, janë synimet kryesore të tre (3) programeve. Mbi bazën e kapaciteteve profesionale në dispozicion, funksionimit të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit ndër-institucional, MZHR do të vazhdojë përpjekjet që të përfshijë edhe programe tjera në analizat e viteve vijuese.

2.1 Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar PZHRB (2021), implementuar nga MZHR

Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2021, është realizuar përmes publikimit dhe realizimit të Skemës së Granteve për biznese, e shpërndarë në lote.

Përkufizimi i lotëve dhe mjetet e dedikuara për secilin lot, kanë qenë si vijon:

- Loti 1 – Start up - ndërmarrje të reja/ fillestare);
Shuma e granteve: 1,000.00 € deri në 5,000.00 €;
- Loti 1 – Ndërmarrjet (ekzistuese) mikro dhe të vogla (qarkullimi minimum 500.00 € deri në 7,000.00 € të dëshmuara nga ATK);
Shuma e granteve: 2,000.00 € deri në 5,000.00 €;

Skema e Granteve bazuar në “Programin Zhvillimor Rajonal të Balancuar” gjatë vitit 2021, ka mbështetur gjithsej (84) projekte, të cilat janë shpërndarë si më poshtë:

- *Në rajonin socio-ekonomik Qendër* (Komuna e Prishtinës me komunat përreth), janë përkrahur gjashtëmbëdhjetë (16) projekte;
- *Në rajonin socio-ekonomik Lindje* (Komuna e Gjilanit me komunat përreth), janë përkrahur tetëmbëdhjetë (18) projekte;
- *Në rajonin socio-ekonomik Perëndim* (Komuna e Pejës me komunat përreth), janë përkrahur tetëmbëdhjetë (18) projekte;
- *Në rajonin socio-ekonomik Veri* (Komuna e Mitrovicës Jugore me komunat përreth), janë përkrahur gjashtëmbëdhjetë (16) projekte;
- *Në rajonin socio-ekonomik Jug* (Komuna e Prizrenit me komunat përreth, gjashtëmbëdhjetë (16) projekte.

Në kuadër të Skemës (PZHRB - 2021), MZHR ka pranuar gjithsej 1209 aplikacione në pesë (5) rajonet zhvillimore të ndara me lotet si vijon:

- *Në Lot1 (Start up) janë pranuar 850 aplikacione;*
- *Në Lot1 (Biznese ekzistuese) janë pranuar 359 aplikacione.*

Sa i përket numrit të përgjithshëm të personave të punësuar në (5) pesë rajonet zhvillimore të Kosovës në kuadër të PZHRB (2021) për dy lotet (L1- Start up dhe Lot1- Biznese ekzistues), në vitin 2021 janë 147 të punësuar të rinjë¹, ku nga ata në:

- *Rajonin Zhvillimor Qendër* – 28 të punësuar të rinjë;
- *Rajonin Zhvillimor Lindje* – 22 të punësuar të rinjë;
- *Rajonin Zhvillimor Perëndim* – 35 të punësuar të rinjë;
- *Rajonin Zhvillimor Veri* – 28 të punësuar të rinjë;
- *Rajonin Zhvillimor Jug* – 34 të punësuar të rinjë.

Referuar edhe analizës tre vjeçare 2018 - 2020 të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar dhe deri në këtë vit, shohim që kërkesa për aplikim Lotin 1 (Start Up) biznese në themelim është gjithnjë e në rritje, program ky që kryesisht përfaqësohet nga kërkesat prej moshave të reja.

¹ ATK (lista e të punësuarve për vitin 2021)

2.2 Programi për Rimëkëmbje Ekonomike PRE-MASA 15, 2021 implementar nga MZHR

Programi për Rimëkëmbje Ekonomike PRE-MASA 15, 2021, është realizuar përmes publikimit dhe realizimit të Skemës së Granteve për biznese ekzistuese e shpërndarë në lote.

Përkufizimi i lotëve dhe mjetet e dedikuara për secilin lot, kanë qenë si vijon:

- Loti 2 – Ndërmarrjet mikro dhe të vogla (qarkullim minimum 7,001.00€ deri 15,000.00€;
Shuma e granteve: 5,000.00 € deri në 10,000.00 €;
- Loti 3 – Ndërmarrjet mikro dhe të vogla (qarkullim minimum 15,001.00€ deri 500,000.00€;
Shuma e granteve: 10,001.00 € deri në 15,000.00 €;

Skema e Granteve bazuar në “Programin për Rimëkëmbje Ekonomike Masa-15, 2021”, ka mbështetur gjithsej (80) projekte, të cilat janë shpërndarë si më poshtë:

- *Në rajonin socio-ekonomik Qendër* (Komuna e Prishtinës me komunat përreth), janë përkrahur tetëmbëdhjetë (18) projekte;
- *Në rajonin socio-ekonomik Lindje* (Komuna e Gjilanit me komunat përreth), janë përkrahur gjashtëmbëdhjetë (16) projekte;
- *Në rajonin socio-ekonomik Perëndim* (Komuna e Pejës me komunat përreth), janë përkrahur tetëmbëdhjetë (18) projekte;
- *Në rajonin socio-ekonomik Veri* (Komuna e Mitrovicës Jugore me komunat përreth), janë përkrahur dymbëdhjetë (12) projekte;
- *Në rajonin socio-ekonomik Jug* (Komuna e Prizrenit me komunat përreth, gjashtëmbëdhjetë (16) projekte.

Ndërkaq në kuadër të Skemës (PRE-MASA 15), 2021, MZHR ka pranuar 743 aplikacione gjithsej, në pesë (5) rajonet zhvillimore të ndara me lote si vijon:

- *Në Lot 2 (Biznese ekzistuese) janë pranuar 273 aplikacione;*
- *Në Lot 3 (Biznese ekzistuese) janë pranuar 470 aplikacione.*

Ndërkaq numri i përgjithshëm të personave të punësuar në (5) pesë rajonet zhvillimore të Kosovës në kuadër të MASA – 15 (2021), në vitin 2021 janë gjithsej 218 të punësuar,² ku nga ata në:

- *Rajonin Zhvillimor Qendër* - 53 të punësuar të rinjë;
- *Rajonin Zhvillimor Lindje* – 35 të punësuar të rinjë;

² ATK (lista e të punësuarve për vitin 2021)

- *Rajonin Zhvillimor Perëndim* - 49 të punësuar të rinjë;
- *Rajonin Zhvillimor Veri* - 36 të punësuar të rinjë;
- *Rajonin Zhvillimor Jug* - 45 të punësuar të rinjë.

Llojet e veprimtarive të projekteve të mbështetura nga Grant Skema për **“Programin për Zhvillim Rajonal të Balacuar 2021”**, përfshinë sektorët e prodhimit dhe shërbimit si: **Prodhim:** Industria e përpunimit të ushqimit - Sektori i miellit dhe produkteve të furrës; Sektori i përpunimit të qumështit dhe produkteve nga qumështi; Industria e përpunimit të metalit; Industria e tekstilit dhe lëkurës; Industria e përpunimit të drurit - sektori i zdrukthtarisë dhe artikujve tjerë nga druri; Sektori I prodhimit të letrës dhe produkteve prej letrës; Industria e plastikës dhe gomës; etj. **Shërbime:** Teknologji informative (Softwer, Hardwer); Gastronomi; Shërbime në fushën e inxhinierisë dhe këshillimit teknik; Ambalazhim i produkteve; Shërbime të parukerisë; Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve; Shërbime financiare; Media, kulturë (krijim filmash), grafik, marketing; Dizajn mode dhe rrobaqepësi; Edukim (pajisje për qendra edukative, çerdhe); Konsulencë (të ndryshme); Tekstil; Operatorë turistikë; Instalimi i makinerive industriale; Shërbime elektrike, hidrosanitare; etj.

Llojet e veprimtarive të projekteve të mbështetura nga Grant Skema për **“Programin për Rimëkëmbje Ekonomike Masa-15, 2021”**, përfshijnë veprimtaritë prodhuese dhe shërbyese si: **Prodhim:** Industria e përpunimit të drurit - Sektori i prodhimit të letrës dhe produkteve prej letrës; Industria e plastikës dhe gomës; Industria e përpunimit të ushqimit- Sektori i miellit dhe produkteve të furrës; Sektori I bletarisë (pajisje për përpunim të mëtejme); Sektori i përpunimit të pemëve dhe perimeve; Përpunim I xhamit; Industria e përpunimit të drurit; Industria e përpunimit të metalit; Industria e tekstilit dhe lëkurës; Pajisje për punim të produkteve të destinuar për ndërtimtari; etj. **Shërbime:** Teknologji informative (Softwer, Hardwer); Media, kulturë, dizajn grafik, marketing, (shërbime filmike, video-produksion); Shtypshkronjë (prodhimi dhe përpunimi i vulave); Dizajn grafik; Shërbime financiare; Konsulencë (të ndryshme); Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve; Shërbime të pastrimit (mirëmbajtjes); Gastronomi; Shërbime të parukerisë; Dizajn mode dhe rrobaqepësi, etj.

Në vitin 2021, është përjashtuar sektori i bujqësisë (për pajisjet që financohen nga MBPZHR), ndërtimit, shëndetësisë dhe tregtisë.

Në tabelat e mëposhtme në vijim të dokumentit do të mund të shihni në formë të detajizuar të gjitha projektet e financuara nga Ministria e Zhvillimit Rajonal për vitin 2021. Programet janë të paraqitura në pesë rajonet socio-ekonomike në Kosovë, të ndara përmes loteve: Lot1(Start Up), Lot1 (biznese ekzistuese), Lot2 dhe Lot3 (biznese ekzistuese). Këtu do të analizojmë dhe

pasqyrojmë shpërndarjen e balancuar të financimit të projekteve nëpër rajone dhe komuna, si dhe do të vërejmë ndikimin që kanë pasur këto programe zhvillimore në zhvillimin rajonal të balancuar në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Vlera e financimit e investuar nga MZHR për dy programet është gjithsej **(1,376,278.62)€**, për pesë (5) rajonet socio-ekonomike zhvillimore. Ndërsa gjithsej vlera bashkëfinancimit për vitin 2021, nga bizneset përfituese për pesë (5) rajonet zhvillimore është **(282,214.51)€**.

2.3 Programi për përkrahjen e NMVM-ve 2021 nga MINT

Me qëllim të përkrahjes së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në funksion të fuqizimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të reja të punës, Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë Tregtisë **MINT** ka shpallur vitet e kaluara programet (fonde) për Inovacion dhe Ndërmarrësi për financimin e Bizneseve Fillestare – “Start-up”, i cili është dizajnuar për të financuar bizneset e reja dhe iniciativat/idetë për krijimin e bizneseve të reja inovative, me qëllim të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të reja të punës. Financimi i “Start-Up” synon fuqizimin ekonomik të rinjve, në jetësimin e ideve inovative dhe planeve të bizneseve.³

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, respektivisht Agjencia KIESA⁴, gjatë vitit 2021, ka shpallur thirrjen publike për subvencionim të NVM-ve për blerjen e makinerive prodhuese /përpunuese, mirëpo lista përfundimtare e përfituesve është publikuar në fillim të vitit 2022. Përzgjedhja e bizneseve përfituese, të cilat janë të përfshira në listën përfundimtare kanë impakt (financohet) në buxhetin e vitit 2022. Ndërsa, Departamenti i Ndërmarrësisë i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë më datë 26.08.2021, ka shpallur thirrjen publike për financimin e Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme në fusha specifike dhe duke u bazuar në raportin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave në MINT, e njëjta thirrje është anuluar sipas vendimit të datës 18.01.2022 me Nr. protokolli: 296/02.

2.4 Programi për përkrahjen e granteve për vitin 2021 nga MBPZHR

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në baza vjetore e mbështet sektorin e bujqësisë dhe zhvillimin rural, përmes granteve investive, investimeve kapitale dhe skemës së pagesave direkte. Masat e programit të zhvillimit rural të cilat janë në proces të zbatimit përfshijnë: Avancimin e kapitali fizik, adaptimin e praktikave të mira të prodhimit, rritjen e

³ Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

⁴ KIESA

prodhimit dhe produktivitetit, përmirësimin e cilësisë dhe zhvillimin e sistemeve të sigurisë së ushqimit, etj.⁵

Objektivat strategjike të PBZHR, kanë të bëjnë me: Rritjen e aftësisë konkurruese të sektorit agro-ushqimor, që bazohet në përdorimin e teknologjisë moderne, rritjen e prodhimit, të produktivitetit dhe sigurisë së ushqimit për të qenë konkurrent në tregun e brendshëm e të jashtëm, si dhe në zvogëlimin e bilancit negativ tregtar; Përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve në zonat rurale nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve në ferma dhe jashtë fermave me qëllim të krijimit të vendeve të punës dhe rritjes së të ardhurave; Mbrojtjen e mjedisit dhe resurseve natyrore, nëpërmjet investimeve në ujitje, kullim, trajtim të mbetjeve, si dhe energji të ripërtëritshme. Zbatimi i Programit për Zhvillim Rural, bëhet në baza vjetore dhe realizohet përmes masave dhe nën masave, si në vijim:

- Masa 101: Investimet në asetet fizike në ekonominë bujqësore;
- Masa 103: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore;
- Masa 302: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve;
- Masa 303: Përgatitja, zbatimi dhe implementimi i strategjive zhvillimore lokale/GLV, qasja LEADER dhe
- Masa: Ujitja e tokave bujqësore, me zbatimin e kësaj mase është synuar.

Sa i përket masave preferenciale të zbatuara në Program: Përparësi kanë pasur projektet që kanë trajtuar ruajtjen e ambientit, përdorimin e energjisë së ripërtëritshme, angazhimin e të rinjve, aplikantët femra dhe zonat e larta rurale (mbi 700 m).

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit rural, përkatësisht Departamenti i Politikave të Zhvillimit Rural/Autoriteti Menaxhues (DPZHR/AM) është përgjegjës për përgatitjen, monitorimin dhe vlerësimin, raportimin, menaxhimin financiar, informimin dhe publicitetin si dhe koordinimin e përgjithshëm të programit. Ndërsa zbatimi i PZHR, bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë që është Agjenci ekzekutive në kuadër të MBPZHR-së.

Përfitues të Programit të Zhvillimit Rural janë:

- Ekonominë bujqësore/personat fizik dhe juridik të regjistruar në Regjistrin e Fermave;

⁵ Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

- Operatorët e ushqimit (përpunimi dhe/ose tregtimi i produkteve bujqësore) të regjistruar në bazë të Ligjit për Investime të Huaja dhe Ligjit për ushqim (103) dhe Ligjit për shoqëritë tregtare;
- Ndërmarrjet jobujqësore në zonat rurale të regjistruara sipas Ligjit për shoqëritë tregtare dhe ligjit për Zejtari;
- Personat fizik dhe juridik në zonat rurale të regjistruar sipas Ligjit për veprimtaritë hoteliere dhe turistike;
- Grupet Lokale të Veprimit/GLV të regjistruara në MAP në bazë të Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural dhe Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare;
- Kompanitë Publike Rajonale të Ujitjes.

Programi i Zhvillimit Rural përmes të cilit jepen grante ndaj sektorit privat (fermerëve dhe bizneseve) mbështetur nga MBPZHR, program ky relevant me programin e MZHR-së, nuk është implementuar për vitin 2021 andaj edhe nuk e kemi të shtjelluar më tej, përveç qëllimit të implementimit të këtij Programi.⁶

⁶ MBPZHR

III. Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar, PZHRB 2021

Përkrahja e sektorit privat

3.1 Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Qendër

Rajoni Zhvillimor Qendër përfshinë tetë (8) Komuna: (Prishtinë, Drenas, Fushë Kosovë, Graçanicë, Shtime, Podujevë Obiliq dhe Lipjan).

Nga Programi për Zhvillim Rajonal në Rajonin Zhvillimor Qendër, janë përkrahur:

- 16 (gjashtëmbëdhjetë) biznese në vlerë prej **78,781.00€**;

Në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar - PZHRB (2021) në rajonin zhvillimor Qendër janë pranuar 419 aplikacione në dy Lotet (Start Up dhe Lot1) nga tetë komunat përbërëse të këtij rajoni. Nga totali i aplikacioneve prej 419, në kategorinë:

- Në Lot 1 - (Start up) janë pranuar 281 aplikacione;
- Në Lot 1 - (Biznese ekzistuese) janë pranuar 138 aplikacione.

Shuma dhe numri i projekteve të financuara nëpër Lote sipas PZHRB (2021) është si vijon:

- Loti 1 (Start Up) – Projekte të reja biznesi:
Shuma e granteve: nga 1,000.00 € deri në 5,000.00 €;
 - Njëmbëdhjetë (11) projekte në vlerë **54,800.00€**;
- Loti 1 (Ndërmarrjet ekzistuese):
Shuma e granteve: nga 2,000.00 € deri në 5,000.00 €;
 - Pesë (5) projekte në vlerë **23,981.00€**.

Vlerat e bashkëfinancimit nga bizneset përfituese (PZHRB 2021) në RZHQ:

- Loti 1 – Projekte të reja biznesi (ndërmarrje të reja/ fillestare) - 10,118.49€;
- Loti 1– Ndërmarrjet ekzistuese– 4,788.00€;

Totali i bashkëfinancimit për dy lotet në Rajonin Zhvillimor Qendër është 14,906.49€.

Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës

Sipas Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB 2021), në rajonin zhvillimor Qendër, sektori më i financuar janë shërbimet me një numër të projekteve prej dymbëdhjetë (12), duke vijuar me sektorin e prodhimit me një numër prej katër (4) projekteve.

Punësimi në dy Lotet në RZHQ sipas PZHRB (2021) është si vijon:

- LOT 1 (Start up) – nëntëmbëdhjetë (19) të punësuar;
- LOT 1 (Biznese ekzistuese) – nëntë (9) të punësuar;

Gjithsej në kuadër të PZHRB (2021) janë 28 të punësuar duke përfshirë (Start Up dhe Lot1) në të gjitha komunat përbërëse të këtij rajoni.

Tabela 1, Paraqitja e të gjitha të dhënave lidhur me realizimin e programeve për përkrahje të sektorit privat në RZHQ (Start Up, PZHRB, 2021)

RAJONI SOCIO-EKONOMIK QENDËR (START UP - PZHRB 2021)										
START UP	Komuna përfituese	Nr. i përgjithshëm I aplikimeve (2021)	Numri I bizneseve përfituese (2021)	Sektorët përfitues	Nr. I projekteve sipas sektorëve	Numri I të punsuarve	Vlera e financuar nga MZHR (€)	Shuma e Bashkëfinancim it nga bizneset	Totali i financimit dhe bashkëfinancimit (2021)	
									Totali MZHR (2021)	Bashkëfinancimi nga Bizneset (2021)
	Prishtinë	167	5	Prodhim	1	10	5,000.00 €	2,552.00 €	24,900.00 €	5,832.49 €
				Shërbime	4		19,900.00 €	3,280.49 €		
	Drenas	22	1	Prodhim	0	1	0.00 €	0.00 €	5,000.00 €	730.00 €
				Shërbime	1		5,000.00 €	730.00 €		
	Fushë Kosovë	27	2	Prodhim	0	2	0.00 €	0.00 €	10,000.00 €	1,326.00 €
				Shërbime	2		10,000.00 €	1,326.00 €		
	Gračanicë	5	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
				Shërbime	0		0.00 €	0.00 €		
	Lipjan	25	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
				Shërbime	0		0.00 €	0.00 €		
	Obiliq	6	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
				Shërbime	0		0.00 €	0.00 €		
	Podujevë	22	3	Prodhim	2	6	9,900.00 €	1,130.00 €	14,900.00 €	2,230.00 €
				Shërbime	1		5,000.00 €	1,100.00 €		
Shtime	7	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	
			Shërbime	0		0.00 €	0.00 €			
Gjithsej: (Start Up)		281	11		11	19	54,800.00	10,118.49	54,800.00	10,118.49

Tabela 2, Paraqitja e të gjitha të dhënave lidhur me realizimin e programeve për përkrahje të sektorit privat në RZHQ (Lot1, PZHRB, 2021)

RAJONI SOCIO-EKONOMIK QENDËR (LOT1 - PZHRB 2021)										
LOT 1	Komuna përfituese	Nr. i përgjithshëm I aplikimeve (2021)	Numri I bizneseve përfituese (2021)	Sektorët përfitues	Nr. I projekteve sipas sektorëve	Numri I të punsuarve	Vlera e financuar nga MZHR (€)	Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset	Tot i financimit dhe bashkëfinancimit (2021)	
									Tot. MZHR(2021)	Bashkëfinancimi nga Bizneset (2021)
	Prishtinë	94	5	Prodhim	1	9	5,000.00 €	2,012.00 €	23,981.00 €	4,788.00 €
				Shërbime	4		18,981.00 €	2,776.00 €		
	Drenas	2	0	Prodhim	0	0	0	0	0	0
				Shërbime	0		0	0		
	Fushë Kosovë	16	0	Prodhim	0	0	0	0	0	0
				Shërbime	0		0	0		
	Gračanicë	3	0	Prodhim	0	0	0	0	0	0
				Shërbime	0		0	0		
	Lipjan	3	0	Prodhim	0	0	0	0	0	0
				Shërbime	0		0	0		
Obiliq	12	0	Prodhim	0	0	0	0	0	0	
			Shërbime	0		0	0			
Podujevë	5	0	Prodhim	0	0	0	0	0	0	
			Shërbime	0		0	0			
Shtime	3	0	Prodhim	0	0	0	0	0	0	
			Shërbime	0		0	0			
Gjithsej: (Lot 1)		138	5		5	9	23,981.00	4,788.00	23,981.00	4,788.00

Tabela 3, Paraqitja e përgjithshme e investimeve për rajonin zhvillimor Qendër (Start Up, Lot1).

RAJONI SOCIO- EKONOMIK QENDËR	Start Up, Lot 1	Nr. i përgjithëshëm I aplikimeve (2021)	Numri I bizneseve përfituese (2021)	Numri I të punsuarve	Vlera e financuar nga MZHR (€)	Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset	Tot i financimit dhe bashkëfinancimit (2021)	
	Start Up	281	11	19	54,800.00 €	10,118.49 €	64,918.49 €	
	LOT 1	138	5	9	23,981.00 €	4,788.00 €	28,769.00 €	
	Gjithsej :	419	16	28	78,781.00	14,906.49	93,687.49	93,687.49

PZHRB (2021) ka realizuar gjithsej shumën e investime në rajonin zhvillimor Qendër në vlerën prej **78,781.00€**, me një numër të përgjithshëm prej gjashtëmbëdhjetë (16) projekte, nga gjithsej 419 numër të aplikuesëve. Në këtë rajon numri më i madh i aplikuesve është pranuar në Lotin (Start Up), me një numër prej 281 të aplikuesëve, ndërsa në këtë Lot përfitues janë njëmbëdhjetë (11) projekte në kuadër të Skemës së PZHRB-së për vitin 2021. Ndërkaq numri më i vogël i aplikimeve është pranuar në Lot 1 (biznes ekzistues), me gjithsej 138 aplikuesë, pesë prej tyre projekte përfituese. Shuma totale e bashkëfinancimit në Rajonin Zhvillimor Qendër është **14,906.49€**, që nënkupton që në RZHQ së bashku me vlerën e bashkëfinancimit janë mbështetur projekte në vlerë të përgjithshme prej **93,687.49€**.

Në Rajonin Zhvillimor Qendër janë punësuar në total 28 persona, ku numri më i madh i të punësuarve është realizuar në kuadër të lotit (Start up) të bizneseve në themelim.

3.2 Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Jug

Rajoni Zhvillimor Jug, përshinë gjashtë (6) komuna të Republikës së Kosovës: (Rahovec, Malishevë, Prizren, Suharekë, Dragash dhe Mamushë).

Nga Programi për Zhvillim Rajonal në Rajonin Zhvillimor Jug, janë përkrahur:

- 16 (gjashtëmbëdhjetë) biznese në vlerë prej **74,949.00€**;

Në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar - PZHRB (2021) në rajonin zhvillimor Jug, janë pranuar 237 aplikacione në dy Lotet (*Start up dhe Lot1*) nga gjashtë komunat përbërëse të këtij rajoni. Nga gjithsej numri i aplikacioneve prej 237, në kategorinë:

- Në Lot 1(*Start up*)- janë pranuar 173 aplikacione;
- Në Lot 1 (*Biznese ekzistuese*)- janë pranuar 64 aplikacione.

Shuma dhe numri i projekteve të financuara nëpër Lote në RZHJ sipas PZHRB (2021) është si vijon:

- Loti 1 (Start Up) – Projekte të reja biznesi:
Shuma e granteve: nga 1,000.00 € deri në 5,000.00 €;
 - 11 projekte përfituese në vlerë **51,155.30€**;
- Loti 1 (Ndërmarrjet ekzistuese):
Shuma e granteve: nga 2,000.00 € deri në 5,000.00 €;
 - 5 projekte në vlerë **23,793.70 €**.

Vlerat e bashkëfinancimit nga bizneset përfituese (PZHRB 2021) në RZHJ:

- Loti 1 (*Start Up*)- Projekte të reja biznesi (*ndërmarrje të reja/ fillestare*)- 6,383.69€;
- Loti 1 (*Ndërmarrjet ekzistuese*)- 3,809.30€.

Totali i bashkëfinancimit për dy lotet në Rajonin Zhvillimor - Jug është 10,192.99€.

Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës

Sipas Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB 2021), në rajonin zhvillimor Jug, sektori më i financuar është sektori i shërbimit me një numër të projekteve prej njëmbëdhjetë (11), duke vijuar me prodhimin ku janë financuar gjithsej pesë (5) projekte përfituese.

Punësimi nëpër Lote në RZHJ sipas PZHRB (2021) është si vijon:

- Lot 1 (*Start up*) - Janë 24 të punësuar të rinjë;

➤ Lot 1 (Biznese ekzistuese) - Janë 10 të punësuar të rinjë.

Gjithsej për vitin 2021 në kuadër të PZHRB (2021) janë punësuar 34 persona duke përfshirë (Start Up dhe Lot1) në gjitha komunat përbërëse të këtij rajoni.

Tabela 4, Paraqitja e të gjitha të dhënave lidhur me realizimin e programeve për përkrahje të sektorit privat në RZHJ (PZHRB, Start Up, 2021)

RAJONI SOCIO-EKONOMIK JUG (START UP-PZHRB 2021)										
START UP	Komuna përfituese	Nr. i përgjithëshëm I aplikimeve (2021)	Numri I bizneseve përfituese (2021)	Sektorët përfitues	Nr. I projekteve sipas sektorëve	Numri I të punsuarve	Vlera e financuar nga MZHR (€)	Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset	Tot i financimit dhe bashkëfinancimit (2021)	
									Tot. MZHR(2021)	Bashkëfinancimi nga Bizneset (2021)
	Prizren	116	8	Prodhim	2	20	9,000.00 €	1,100.00 €	36,205.30 €	4,557.69 €
				Shërbime	6		27,205.30 €	3,457.69 €		
	Dragash	10	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
				Shërbime	0		0.00 €	0.00 €		
	Malishevë	15	2	Prodhim	2	2	9,950.00 €	1,230.00 €	9,950.00 €	1,230.00 €
				Shërbime	0		0.00 €	0.00 €		
	Mamushë	4	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
				Shërbime	0		0.00 €	0.00 €		
	Rahovec	13	1	Prodhim	0	2	0.00 €	0.00 €	5,000.00 €	596.00 €
				Shërbime	1		5,000.00 €	596.00 €		
Suharekë	15	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	
			Shërbime	0		0.00 €	0.00 €			
Gjithsej: (Start Up)		173	11		11	24	51,155.30 €	6,383.69 €	51,155.30 €	6,383.69 €

Tabela 5, Paraqitja e të gjitha të dhënave lidhur me realizimin e programeve për përkrahje të sektorit privat në RZHZ (Lot1, PZHRB, 2021)

RAJONI SOCIO-EKONOMIK JUG (LOT 1 - PZHRB 2021)										
LOT 1	Komuna përfituese	Nr. i përgjithshëm I aplikimeve (2021)	Numri I bizneseve përfituese (2021)	Sektorët përfitues	Nr. I projekteve sipas sektorëve	Numri I të punsuarve	Vlera e financuar nga MZHR (€)	Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset	Tot i financimit dhe bashkëfinancimit (2021)	
									Tot. MZHR(2021)	Bashkëfinancimi nga Bizneset (2021)
	Prizren	45	3	Prodhim	1	8	5,000.00 €	1,135.00 €	14,800.00 €	2,635.00 €
				Shërbime	2		9,800.00 €	1,500.00 €		
	Dragash	2	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
				Shërbime	0		0.00 €	0.00 €		
	Malishevë	1	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
				Shërbime	0		0.00 €	0.00 €		
	Mamushë	2	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
				Shërbime	0		0.00 €	0.00 €		
	Rahovec	4	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
				Shërbime	0		0.00 €	0.00 €		
	Suharekë	10	2	Prodhim	0	2	0.00 €	0.00 €	8,993.70 €	1,174.30 €
				Shërbime	2		8,993.70 €	1,174.30 €		
Gjithsej: (LOT 1)		64	5		5	10	23,793.70	3,809.30	23,793.70	3,809.30

Tabela 6, Paraqitja e përgjithshme e investimeve për rajonin zhvillimor Jug (Start Up, Lot1).

	Start Up, Lot 1	Nr. i përgjithshëm I aplikimeve (2021)	Numri I bizneseve përfituese (2021)	Numri I të punsuarve	Vlera e financuar nga MZHR (€)	Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset	Tot i financimit dhe bashkëfinancimit (2021)
RAJONI SOCIO-EKONOMIK JUG	Start Up	173	11	24	51,155.30 €	6,383.69 €	57,538.99 €
	LOT 1	64	5	10	23,793.70 €	3,809.30 €	27,603.00 €
	Gjithsej :	237	16	34	74,949.00	10,192.99	85,141.99 €

PZHRB 2021 ka realizuar në total shumën e investime në Rajonin Zhvillimor Jug në vlerën prej **74,949.00 €**, me numër të përgjithshëm prej (16) projekte përfituese, nga gjithsej numri i aplikuesëve prej 237. Në këtë rajon, numri më i madh i aplikuesëve është pranuar në L1 (Start up), me një numër prej 173 të aplikuesëve, ndërsa kanë përfituar (11) projekte në kuadër të “PZHRB 2021”. Numri më i vogël i aplikimeve është pranuar në Lot 1, me (64) aplikuesë, nga këta (5) projekte përfituese në kuadër të këtij Loti. Shuma totale e bashkëfinancimit në Rajonin Zhvillimor Jug është **10,192.99€**, që nënkupton që në RZHJ së bashku me vlerën e bashkëfinancimit janë mbështetur projekte në vlerë të përgjithshme prej **85,141.99€**.

Në Rajonin Zhvillimor Jug janë punësuar gjithsej (34) persona, ku numri më i madh i të punësuarëve është realizuar në kuadër të Lot 1 (Start Up) me (24) të punësuar të rinjë.

3.3 Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Perëndim

Rajoni zhvillimor Perëndim përfshinë gjashtë (6) komuna: (Pejë, Klinë, Istog, Junik, Deçan dhe Gjakovë).

Nga Programi për Zhvillim Rajonal në Rajonin Zhvillimor Perëndim, janë përkrahur:

- 18 (tetëmbëdhjetë) biznese në vlerë prej **82,745.04€**;

Në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar - PZHRB (2021) në rajonin zhvillimor Perëndim janë pranuar 168 aplikacione në dy Lotet (Start Up dhe Lot 1) nga gjashtë komunat përbërëse të këtij rajoni. Nga totali i aplikacioneve prej 168, në kategorinë:

- Në Lot 1 (Start up) janë pranuar 123 aplikacione;
- Në Lot 1 (Biznese ekzistuese) janë pranuar 45 aplikacione.

Shuma dhe numri i projekteve të financuara nëpër Lote në RZHP sipas PZHRB (2021) është si vijon:

- Loti 1 - (Start Up) – Projekte të reja biznesi
Shuma e granteve: nga 1,000.00 € deri në 5,000.00 €;
 - 12 projekte në vlerë **56,137.04€**;
- Loti 1 - Ndërmarrjet ekzistuese
Shuma e granteve: nga 2,000.00 € deri në 5,000.00 €;
 - 6 projekte në vlerë **26,608.00€**;

Vlerat e bashkëfinancimit nga bizneset përfituese (PZHRB 2021) në RZHP:

- Loti 1 (Start Up)- (Projekte të reja biznes, ndërmarrje të reja/ fillestare) – 8,241.82€;
- Loti 1 (Ndërmarrjet ekzistuese) - 5,217.00€;

Totali i bashkëfinancimit për dy (2) lotet në Rajonin Zhvillimor Perëndim është 13,458.82€.

Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës

Sipas Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB 2021), në rajonin zhvillimor Perëndim, sektori më i financuar është sektori i shërbimit me një numër të projekteve prej (13), duke vijuar me sektorin e prodhimit ku janë financuar gjithsej (5) projekte përfituese.

Punësimi nëpër Lote në RZHP sipas PZHRB (2021) është si vijon:

- LOT 1 (Start Up) – 23 të punësuar të rinjë;
- LOT 1 (Biznese ekzistuese) – 12 të punësuar të rinjë.

Gjithsej për vitin 2021 në kuadër të PZHRB (2021) janë punësuar 35 persona duke përfshirë Lot1 (Start up) dhe Lot1 (Biznese ekzistuese) në gjitha komnatat përbërëse të këtij rajoni.

Tabela 7, Paraqitja e të gjitha të dhënave lidhur me realizimin e programeve për përkrahje të sektorit privat në RZHP (Start Up, PZHRB, 2021)

RAJONI SOCIO-EKONOMIK PERËNDIM (START UP - PZHRB 2021)										
START UP	Komuna përfituese	Nr. i përgjithëshëm I aplikimeve (2021)	Numri I bizneseve përfituese (2021)	Sektorët përfitues	Nr. I projekteve sipas sektorëve	Numri I të punsuarve	Vlera e financuar nga MZHR (€)	Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset	Tot i financimit dhe bashkëfinancimit (2021)	
									Tot. MZHR(2021)	Bashkëfinancimi nga Bizneset (2021)
	Pejë	39	3	Prodhim	1	5	5,000.00 €	950.00 €	15,000.00 €	3,350.00 €
				Shërbime	2		10,000.00 €	2,400.00 €		
	Istog	16	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
Gjithsej: (LOT 3)		45	8		8	27	116,700.00 €	27,040.00 €	116,700.00 €	27,040.00 €

Tabela 27, Paraqitja e përgjithshme e investimeve për rajonin zhvillimor Veri (Lot2, Lot3).

RAJONI SOCIO- EKONOMIK VERI	LOT 2, LOT 3	Nr. i përgjithshëm I aplikimeve (2021)	Numri I bizneseve përfituese (2021)	Numri I të punuarve	Vlera e financuar nga MZHR (€)	Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset	Tot i financimit dhe bashkëfinancimit (2021)
	LOT 2	29	4	9	40,000.00 €	13,094.03 €	53,094.03 €
	LOT 3	45	8	27	116,700.00 €	27,040.00 €	143,740.00 €
	Gjithsej :	74	12	36	156,700.00 €	40,134.03 €	196,834.03 €

PRE-MASA 15, 2021 ka realizuar në total shumën e investimeve në Rajonin Zhvillimor Veri në vlerën prej **156,700,00€**, me një numër të përgjithshëm prej (12) projekte përfituese nga gjithsej totali i aplikuesëve prej 74. Në këtë rajon numri më i madh i aplikuesëve të projekteve është pranuar në Lot3 me një numër prej (45) të aplikuesëve, ndërsa kanë fituar 8 projekte në kuadër të PRE-MASA-15, 2021. Numri më i vogël i aplikimeve është pranuar në Lot2, ku kanë aplikuar vetëm 29 aplikuesë, nga këta (4) projekte përfituese në kuadër të këtij Loti. Shuma totale e bashkëfinancimit në rajonin zhvillimor Veri është **40,134.03€** që nënkupton që në RZHV së bashku me vlerën e bashkëfinancimit janë mbështetur projekte në vlerë të përgjithshme prej **196,834.03 €**.

Në Rajonin Zhvillimor Veri janë punësuar në total (36) persona, ku numri më i madh i të punësuarëve është realizuar në kuadër të Lot 3, me (27) numër të punësuarëve të rinjë.

4.5 Përkrahja e sektorit privat – Rajoni Zhvillimor Lindje

Rajoni Zhvillimor Lindje përfshinë njëmbëdhjetë (11) komuna: (Ferizaj, Gjiilan, Han I Elezit, Kaçanik, Novobërdë, Shtërpce, Viti, Klokot, Ranillug, Kamenicë dhe Partesh).

Nga Programi për Rimëkëmbje Ekonomike MASA-15, 2021, në rajonin zhvillimor Lindje, janë përkrahur:

- 16(gjashtëmbëdhjetë) biznese përfituese në vlerë prej **190,190.00€**;

Në kuadër të Programit për Rimëkëmbje Ekonomike PRE-MASA-15, 2021 në rajonin zhvillimor Lindje janë pranuar (147) aplikacione në dy Lotet (Lot2 dhe Lot3) nga të gjitha komunat përbërëse të këtij rajoni. Nga totali i aplikimeve, në kategorinë:

- Në Lot 2 (Biznese ekzistuese) janë pranuar 63 aplikacione;
- Në Lot 3 (Biznese ekzistuese) janë pranuar 84 aplikacione;

Shuma dhe numri i projekteve të financuara nëpër Lote në RZHL sipas PRE-MASA-15, 2021 është si vijon:

- Loti 2 – Ndërmarrjet mikro dhe të vogla (qarkullim minimum 7,001.00€ deri 15,000.00€;
Shuma e granteve: 5,000.00 € deri në 10,000.00 €;
 - 9 projekte në vlerë **86,390.00 €**;
- Loti 3 – Ndërmarrjet mikro dhe të vogla (qarkullim minimum 15,001.00€ deri 500,000.00€;
Shuma e granteve: 10,001.00 € deri në 15,000.00 €;
 - 7 projekte në vlerë **103,800.00 €**.

Vlerat e bashkëfinancimit nga bizneset përfituese PRE-MASA-15, 2021, në RZHL:

- Loti 2 – Ndërmarrjet ekzistuese (ndërmarrje deri në 2 vjet) – 17,297.55€;
- Loti 3 – Ndërmarrje të vogla (mbi 2 vjet)– 25,004.54€;

Totali i bashkëfinancimit për 2 (dy) lotet në rajonin zhvillimor Lindje është 42,302.09€.

Sektorët përfitues dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës

Sipas Programit për Rimëkëmbje Ekonomike PRE-MASA-15, 2021 në rajonin zhvillimor Lindje, sektori më i financuar janë shërbimet me një numër të projekteve prej (9) nëntë, duke vijuar me prodhimin ku kemi një numër prej (7) shtatë të projekteve përfituese.

- Ndërkaq punësimi nëpër Lote në RZHL sipas PRE-MASA 15, 2021 është si vijon:

- *Lot 2- Biznese ekzisutese - Janë 19 të punësuar të rinjë;*
- *Lot 3- Biznese ekzisutese - Janë 16 të punësuar të rinjë;*

Në total për vitin 2021 në kuadër të PRE-MASA-15, janë punësuar (35) persona duke përfshirë dy lotet në të gjitha komunat përbërëse të këtij rajoni.

Tabela 28, Paraqitja e të gjitha të dhënave lidhur me realizimin e programeve për përkrahje të sektorit privat në RZHL (MASA-15, Lot2, 2021)

RAJONI SOCIO-EKONOMIK LINDJE (LOT 2 - MASA 15, 2021)										
	Komuna përfituese	Nr. i përgjithëshëm I aplikimeve (2021)	Numri I bizneseve përfituese (2021)	Sektorët përfitues	Nr. I projekteve sipas sektorëve	Numri I të punsuarve	Vlera e financuar nga MZHR (€)	Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset	Tot i financimit dhe bashkëfinancimit (2021)	
									Tot. MZHR(2021)	Bashkëfinancimi nga Bizneset (2021)
LOT 2	Gjilan	26	3	Prodhim	0	5	0.00 €	0.00 €	28,000.00 €	5,932.55 €
				Shërbime	3		28,000.00 €	5,932.55 €		
	Novobërdë	2	1	Prodhim	1	1	9,990.00 €	1,110.00 €	9,990.00 €	1,110.00 €
				Shërbime	0		0.00 €	0.00 €		
	Kamenicë	6	2	Prodhim	1	2	9,500.00 €	1,150.00 €	19,500.00 €	2,950.00 €
				Shërbime	1		10,000.00 €	1,800.00 €		
	Ferizaj	17	1	Prodhim	1	2	10,000.00 €	4,200.00 €	10,000.00 €	4,200.00 €
				Shërbime	0		0.00 €	0.00 €		
	Kaçanik	1	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
				Shërbime	0		0.00 €	0.00 €		
	Shtërpcë	1	1	Prodhim	0	2	0.00 €	0.00 €	8,910.00 €	1,000.00 €
				Shërbime	1		8,910.00 €	1,000.00 €		
	Viti	5	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
				Shërbime	0		0.00 €	0.00 €		
	Hani Elezit	2	1	Prodhim	0	7	0.00 €	0.00 €	9,990.00 €	2,105.00 €
				Shërbime	1		9,990.00 €	2,105.00 €		
	Kllokot	1	0	Prodhim	0		0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
				Shërbime	0		0.00 €	0.00 €		
	Ranillugë	2	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
				Shërbime	0		0.00 €	0.00 €		
	Partesh	0	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
				Shërbime	0		0.00 €	0.00 €		
Gjithsej: (LOT 2)		63	9		9	19	86,390.00 €	17,297.55 €	86,390.00 €	17,297.55 €

Tabela 29, Paraqitja e të gjitha të dhënave lidhur me realizimin e programeve për përkrahje të sektorit privat në RZHL (MASA-15, Lot3, 2021)

RAJONI SOCIO-EKONOMIK LINDJE (LOT 3 - MASA 15, 2021)										
LOT 3	Komuna përfituese	Nr. i përgjithëshëm I aplikimeve (2021)	Numri I bizneseve përfituese (2021)	Sektorët përfitues	Nr. I projekteve sipas sektorëve	Numri I të punsuarve	Vlera e financuar nga MZHR (€)	Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset	Tot i financimit dhe bashkëfinancimit (2021)	
									Tot. MZHR(2021)	Bashkëfinancimi nga Bizneset (2021)
	Gjilan	27	1	Prodhim	1	2	14,800.00 €	1,700.00 €	14,800.00 €	1,700.00 €
				Shërbime	0		0.00 €	0.00 €		
	Novobërdë	1	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
				Shërbime	0		0.00 €	0.00 €		
	Kamenicë	17	6	Prodhim	3	14	45,000.00 €	16,700.34 €	89,000.00 €	23,304.54 €
				Shërbime	3		44,000.00 €	6,604.20 €		
	Ferizaj	28	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
				Shërbime	0		0.00 €	0.00 €		
	Kaçanik	2	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
				Shërbime	0		0.00 €	0.00 €		
	Shtërpçë	0	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
				Shërbime	0		0.00 €	0.00 €		
	Viti	8	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
				Shërbime	0		0.00 €	0.00 €		
	Hani Elezit	0	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
				Shërbime	0		0.00 €	0.00 €		
	Kllokot	0	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
				Shërbime	0		0.00 €	0.00 €		
Ranillugë	1	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	
			Shërbime	0		0.00 €	0.00 €			
Partesh	0	0	Prodhim	0	0	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	
			Shërbime	0		0.00 €	0.00 €			
Gjithsej: (LOT 3)		84	7		7	16	103,800.00 €	25,004.54 €	103,800.00 €	25,004.54 €

Tabela 30, Paraqitja e përgjithshme e investimeve për rajonin zhvillimor Lindje (Lot2, Lot3).

RAJONI SOCIO-EKONOMIK LINDJE	LOT 2, LOT 3	Nr. i përgjithshëm I aplikimeve (2021)	Numri I bizneseve përfituese (2021)	Numri I të punësuarve	Vlera e financuar nga MZHR (€)	Shuma e Bashkëfinancimit nga bizneset	Tot i financimit dhe bashkëfinancimit (2021)
	LOT 2	63	9	19	86,390.00 €	17,297.55 €	103,687.55 €
	LOT 3	84	7	16	103,800.00 €	25,004.54 €	128,804.54 €
	Gjithsej :	147	16	35	190,190.00 €	42,302.09 €	232,492.09 €

PRE-MASA-15, 2021 ka realizuar në total shumën e investime në Rajonin Zhvillimor Lindje në vlerën prej **190,190.00€** me një numër të përgjithshëm prej (16) projekteve përfituese nga totali i aplikuesëve prej 147. Në këtë rajon numri më i madh i aplikuesëve është pranuar në Lot3 me një numër prej 84, ndërsa kanë përfituar (7) projekte në kuadër të skemës PRE-MASA-15, (2021). Numri më i vogël i aplikimeve është pranuar në Lot 2, ku kanë aplikuar 63 persona, por nga këta kemi (9) projekte përfituese në kuadër të këtij Loti. Shuma totale e bashkëfinancimit në rajonin zhvillimor Lindje është **42,302.09€** që nënkupton që në RZHL së bashku me vlerën e bashkëfinancimit janë mbështetur projekte në vlerë të përgjithshme prej **232,492.09€**.

Në Rajonin Zhvillimor Lindje janë punësuar në total 35 persona, ku numri më i madh i të punësuarve është realizuar në kuadër të Lot2

V. Paraqitja grafike e të dhënave rajonale (PZHRB DHE PRE-MASA 15), 2021

Në këtë kapitull janë të paraqitura të dhënat në formë të grafikunit, në përqindje (%), dhe në formë tabelare si dhe të interpretuara në narracion për pesë (5) rajonet socio-ekonomike zhvillimore në Kosovë si: (Rajonin Qendër, Rajonin Veri, Rajonin Jug, Rajonin Lindje dhe Rajonin Perëndim), në lidhje me implementimin e “Programit të Zhvillimit Rajonal të Balancuar PZHRB, 2021” dhe “Programin për Rimëkëmbje Ekonomike MASA-15, 2021”. Gjithashtu vlerat e financimit të projekteve të implementuara janë të paraqitura dhe të ndara në Lote (Lot1- Start up dhe Lot1 - Biznes ekzistues) të programit PZHRB, dhe (Lot2 dhe Lot3 Biznese ekzistuese), të programit PRE-MASA 15, për secilin rajon në veçanti me qëllim të një pasqyrimi më të qartë dhe transparent të pesë (5) rajoneve zhvillimore.

Tabela 31, Paraqitja e përgjithshme e investimeve për dy programet PZHRB dhe MASA 15.


PZHRB (2021)			PRE-MASA 15 (2021)		
Rajonet zhvillimore	Vlera e financimit	Nr.i projekteve të implementuara	Rajonet zhvillimore	Vlera e financimit	Nr.i projekteve të implementuara
RZHQ	78,781.00	16	RZHQ	216,402.00	18
RZHJ	74,949.00	16	RZHJ	198,310.00	16
RZHP	82,745.04	18	RZHP	218,455.00	18
RZHV	77,240.90	16	RZHV	156,700.00	12
RZHL	82,505.68	18	RZHL	190,190.00	16
GJITHSEJ	396,221.62€	84	TOTAL	980,057.00€	80
Vlera totale për dy programet (1,376,278.62)€					

Ashtu siç edhe janë paraqitur në tabelë, në këtë analizë ne kemi shtjelluar vlerat e financimit dhe numrin e projekteve përfituese për pesë rajonet zhvillimore të “PZHRB 2021” dhe “MASA-15”, 2021. Totali i financimit për “PZHRB 2021”, për pesë rajonet zhvillimore përmban vlerën e shpenzuar prej (396,221.62€), përfshirë implementimin e (84) projekteve përfituese të vitit 2021, Në llogaritjet e (84) projekteve përfituese (PZHRB) në total janë përfshirë (pagesat I dhe II të ekzekutuara brenda vitit 21/22), ndërsa totali i financimit për PRE-MASA-15, 2021 për pesë rajonet zhvillimore përmban vlerën e shpenzuar prej (980,057.00€) për (80) projekte përfituese suksesshëm të implementuara .

5.1 Rajoni Zhvillimor Qendër

Në Rajonin Zhvillimor Qendër nga të dy programet janë investuar gjithsej **295,183.00€**, me një numër të përgjithshëm prej **34** projekteve përfituese.


Grafiku 1. Paraqitja grafike e programeve “PZHRB” dhe “MASA-15”, në RZHQ



5.2 Rajoni Zhvillimor Jug

Në Rajonin Zhvillimor Jug nga të dy programet janë investuar gjithsej **273,259.00€**, me një numër të përgjithshëm prej **32** projekteve përfituese.


Grafiku 2. Paraqitja grafike e programeve “PZHRB” dhe “MASA- 15” në RZHJ



5.3 Rajoni Zhvillimor Perëndim

Në Rajonin Zhvillimor Perëndim nga të dy programet janë investuar gjithsej **301,200.04€**, me një numër të përgjithshëm prej **36** projekteve përfituese.


Grafiku 3. Paraqitja grafike e dy programeve “PZHRB” dhe “MASA-15” në RZHP



5.4 Rajoni Zhvillimor Veri

Në Rajonin Zhvillimor Perëndim nga të dy programet janë investuar gjithsej **233,940.90€**, me një numër të përgjithshëm prej **28** projekteve përfituese.


Grafiku 4. Paraqitja grafike e programeve “PZHRB” dhe “MASA – 15”, në RZHV



5.5 Rajoni Zhvillimor Lindje

Në Rajonin Zhvillimor Lindje nga të dy programet janë investuar gjithsej **272,695.68€**, me një numër të përgjithshëm prej **34** projekteve përfituese.

Grafiku 5. Paraqitja grafike e programeve “PZHRB” dhe “MASA -15”, në RZHL



5.6 Paraqitja grafike dhe numerike e punësimit në kuadër të dy skemave të programeve për mbështetjen e sektorit privat


Në tabelën dhe grafikonet më poshtë kemi paraqitur dhe krahasuar numrin e të punësuarve të rinjë në lidhje me implementimin e dy programeve të realizuar nga MZHR për vitin 2021.

Tabela 32, Paraqitja tabelare e nr. të punësuarëve në kuadër të programeve “PZHRB” dhe “MASA 15”, në pesë (5) rajone zhvillimore

Punësimi					
PZHRB(2021)			MASA 15 (2021)		
Rajonet zhvillimore	Nr. I të punësuarve	Punësimi sipas Loteve	Rajonet zhvillimore	Nr. I të punësuarve	Punësimi sipas Loteve
RZHQ	28	Lot1(Start Up) 19	RZHQ	53	(Lot 2) 23
		Lot1(Biznese Egzistuese) 9			(Lot 3) 30
RZHJ	34	Lot1(Start Up) 24	RZHJ	45	(Lot 2) 15
		Lot1(Biznese Egzistuese) 10			(Lot 3) 30
RZHP	35	Lot1(Start Up) 23	RZHP	49	(Lot 2) 22
		Lot1(Biznese Egzistuese) 12			(Lot 3) 27
RZHV	28	Lot1(Start Up) 21	RZHV	36	(Lot 2) 9
		Lot1(Biznese Egzistuese) 7			(Lot 3) 27
RZHL	22	Lot1(Start Up) 15	RZHL	35	(Lot 2) 19
		Lot1(Biznese Egzistuese) 7			(Lot 3) 16
Total (PZHRB) - 147 të punësuar			Total (Masa - 15) - 275 të punësuar		
Total të punësuar: 422					

Këtu vërejmë që numri më i madh i të punësuarve të rinjë është arritur nga implementimi i programit PRE-MASA 15, me një numër prej 275 të punësuar për pesë rajonet zhvillimore.

Grafiku 6 dhe 7, Paraqitja grafike e të punësuarve sipas pesë(5) rajoneve zhvillimore “PZHRB dhe “MASA 15”



VI. Shuma e përgjithshme e investimeve në vlerë dhe (%), përfshirë lotet (Lot1-Start up, Lot1-Biznes ekzistues), në pesë (5) Rajonet Zhvillimore në Kosovë

Programi për Zhvillimi Rajonal të Balancuar PZHRB implementuar gjatë vitit 2021


Në tabelën vijuese kemi paraqitur vlerat totale të financimit dhe bashkëfinancimit për secilin rajon veç e veç ku vërejmë një shpërndarje mjaft të mirë balancuar të investimeve nëpër rajonet socio-ekonomike rajonale me diferenca të vogla prej 1% - 2% mes rajoneve sipas vlerës totale të financimit 396,221.62 € për pesë (5) rajonet zhvillimore.

Tabela 33. Paraqitja tabelare e shpërndarjes së mjeteve financiare sipas pesë (5) rajoneve zhvillimore (PZHRB 2021)


TOTALI I VLERAVE TË FINANCIMIT DHE BASHKËFINANCIMIT SIPAS RAJONEVE EKONOMIKE - PZHRB 2021				
PESË (5) RAJONET SOCIO- EKONOMIKE	VLERA E FINANCIMIT- PZHRB 2021 (€)	%	VLERA E BASHKËFINANCIMIT NGA BIZNESET	%
Rajoni Socio Ekonomik Qendër	78,781.00 €	20%	14,906.49 €	23%
Rajoni Socio-Ekonomik Jug	74,949.00 €	19%	10,192.99 €	15%
Rajoni Socio- Ekonomik Perëndim	82,745.04 €	21%	13,458.82 €	20%
Rajoni Socio-Ekonomik Veri	77,240.90 €	19%	15,606.47 €	24%
Rajoni Socio –Ekonomik Lindje	82,505.68 €	21%	11,862.91 €	18%
Gjithsej	396,221.62 €	100%	66,027.68 €	100%
Gjithsej Financimi dhe Bashkfinancimi	462,249.30 €			

Ndërkaq në grafikonet e mëposhtëm kemi paraqitur shpërndarjen e mjeteve financiare sipas pesë rajone zhvillimore për programin “PZHRB” për vitin 2021.

Grafiku 8. Paraqitja grafike e financimit dhe bashkëfinancimit nga MZHR në kuadër të programit mbështetës “PZHRB” implementuar në v.2021



Grafiku 9. dhe 10, Paraqitja grafike në % e financimit dhe bashkëfinancimit nga MZHR në kuadër të programit mbështetës “PZHRB” implementuar në v.2021




Më poshtë kemi bërë edhe krahasimin e vlerës së financimit dhe numrit të projekteve përfituese sipas Loteve brenda programit “PZHRB-2021”.


Tabela 34. Paraqitja tabelare e shpërndarjes së mjeteve financiare dhe numri i projekteve sipas pesë (5) rajoneve zhvillimore (PZHRB 2021)

VLERA E FINANCIMIT DHE NUMRI I PROJEKTEVE SIPAS LOTEVE PZHRB - 2021				
RAJONET SOCIO-EKONOMIKE	VLERA E FINANCIMIT (START UP)	VLERA E FINANCIMIT (LOT 1)	NUMRI I PROJEKTEVE (START UP)	NUMRI I PROJEKTEVE (LOT 1)
Rajoni Socio-Ekonomik Qendër	54,800.00 €	23,981.00 €	11	5
Rajoni Socio-Ekonomik Jug	51,155.30 €	23,793.70 €	11	5
Rajoni Socio-Ekonomik Perëndim	56,137.04 €	26,608.00 €	12	6
Rajoni Socio-Ekonomik Veri	53,201.30 €	24,039.60 €	11	5
Rajoni Socio- Ekonomik Lindje	54,130.68 €	28,375.00 €	12	6
Gjithsej	269,424.32 €	126,797.30 €	57	27
Gjithsej vlera e financimit dhe numri i projekteve (Start Up dhe Lot 1)	396,221.62 €		84	

Grafiku 11. Shuma e përgjithshme e financimit në programin “PZHRB” sipas (Lot1- Start Up dhe Lot 1- Biznes Egzistuese) në pesë (5) Rajonet Zhvillimore në Kosovë



Grafiku 12. Numri i projekteve përfituese nga bizneset në programin “PZHRB” sipas (Lot1- Start Up dhe Lot 1- Biznese Egzistuese) në pesë (5) Rajonet Zhvillimore në Kosovë




6.1 Shuma e përgjithshme e investimeve në (%) sipas sektorëve në kuadër të programit mbështetës “PZHRB – 2021”

Konsideruar paraqitjen grafikoneve të mëposhtëm shohim se 23 projekte apo 27% e përfituesve janë mbështetur në sektorin e prodhimit dhe 61 projekte apo 73% e përfituesve, janë mbështetur në sektorin e shërbimeve. Bazuar në Lotet që janë mbështetur, vlerat e qarkullimit sipas tyre, shohim se numri më i madh i bizneseve është mbështetur në veprimtarinë e shërbimeve që korrespondojnë me bizneset e reja “Start Up”.

Grafiku 13. Paraqitja grafike në % e sektorëve përfitues sipas pesë (5) rajoneve zhvillimore në kuadër të programit mbështetës “PZHRB”



Grafiku 14. Paraqitja grafike e shpërndarjes së projekteve sipas sektorëve përfitues në pesë (5) rajoneve zhvillimore në kuadër të programit mbështetës “PZHRB”




6.2 Paraqitja tabelare e shpërndarjes së projekteve sipas komuniteteve në rajone zhvillimore

Nga paraqitja tabelare e mëposhtme ku janë paraqitur numri i përfituesve sipas përkatësisë etnike vërejmë që ka komunitete të cilat në kuadër të programit “PZHRB-2021”, nuk kanë përfituar nga ky program mbështetës sikurse komuniteti boshnjak si dhe ai rom, ashkali dhe egjiptas. Nga ky program përfituesit më të shumtë në numër janë komuniteti shqiptar si komuniteti më i madh me gjithsej 77 përfitues, pastaj komuniteti turk dhe serb me numër të barabartë të përfituesve dhe një përfitues nga komuniteti goran nga totali prej 84 përfituesve të PZHRB-së.

Tabela 35, Paraqitja tabelare e shpërndarjes së mjeteve financiare sipas përkatësisë etnike, në pesë pesë (5) rajone zhvillimore (PZHRB 2021)

Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar – PZHRB (Start Up dhe Lot1)								
Pesë(5) Rajonet Zhvillimore	Përkatësia Etnike							Gjithsej numri i përfituesëve
	Viti	Shqiptar	Serb	Boshnjak	Turk	Goran	Rom, Ashkali, Egjiptas	
	2021	77	3	0	3	1	0	84
Gjithsej numri i përfituesëve	84							

Grafiku 15. Paraqitja grafike shpërndarjes së projekteve sipas përkatësisë etnike PZHRB



6.3 Projektet përfituese nga gratë për vitin 2021, programi “PZHRB”

Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar, për vitin 2021 ka mbështetur financiarisht (34) tridhjetë e katër biznese të udhëhequra nga gratë dhe (50) pesëdhjetë biznese të udhëhequra nga burrat. Numri më i madh i projekteve të financuara për gratë është në Rajonin Zhvillimor Jug, me gjithsej 9 (nëntë) projekte përfituese.

Sipas tabelës së mëposhtme gra përfituese janë nga të gjitha rajonet zhvillimore, ku rajoni zhvillimor Jug ka numrin më të madh të përfitueseve gra me gjithsej (9) biznese përfituese duke vijuar me rajonin Perëndim dhe Lindje me 7 projekte, rajonin Veri me 6 projekte dhe i fundit rajoni Qendër me 5 projekte. Vërejmë që në dallim me “Programin për Rimëkëmbje Masa -15” ku dallojnë Lotet që janë mbështetur, shohim se kemi një nr. të madh të grave që kanë aplikuar në (*Lot 1 Start Up*) prandaj dallimi mes dy programeve është më një diferencë prej 23 projekteve më shumë të mbështetura në PZHRB. Përqindja dalluese mes bizneseve të udhëhequr nga burrat kundrejt atyre nga gratë mbetet me një përqindje prej 40% gra përfituese dhe 60% biznese të udhëhequra nga burrat.

MZHR duhet të mbështesë sa më shumë bizneset e udhëhequra nga gratë në Lote më të mëdha duke stimuluar qëndrueshmërinë e tyre dhe zgjerimin e kapaciteteve të bizneseve. Gjithashtu mbetet një përkushtim çdoherë stimulimi i ideve inovative në kuadër të Start Up-ve.


6.3.1 Shpërndarja tabelare e projekteve përfituese të udhëhequra nga gratë në pesë (5) rajone zhvillimore në Kosovë

Tabela 36, Paraqitja tabelare e shpërndarjes së mjeteve të projekteve të udhëhequra nga gratë në pesë (5) rajone zhvillimore (PZHRB 2021)

PESE (5) RAJONET ZHVILLIMORE	NUMRI I PËRGJITHSHËM I PROJEKTEVE
Rajoni socio Ekonomik Qendër	5
Rajoni Socio-Ekonomik Jug	9
Rajoni socio- Ekonomik Perëndim	7
Rajoni Socio-Ekonomik Veri	6
Rajoni Socio –Ekonomik Lindje	7
GJITHSEJ:	34

6.3.2 Paraqitja grafike në % e shpërndarjes së tridhjetë e katër (34) projekteve të udhëhequra nga grate në pesë (5) rajonet zhvillimore në Kosovë

Grafiku 16 dhe 17. Shpërndarja e përgjithshme e projekteve të udhëhequra në baza gjinore në % , sipas pesë (5) rajoneve zhvillimore (PZHRB 2021).



VII. Shuma e përgjithshme e investimeve në vlerë dhe (%), përfshirë lotet (Lot2 dhe Lot 3 - Biznese ekzistuese), në pesë (5) Rajonet Zhvillimore në Kosovë

Programi për Rimëkëmbje Ekonomike PRE-MASA 15 implementuar gjatë vitit 2021


Në tabelën vijuese kemi paraqitur vlerat totale të financimit dhe bashkëfinancimit për secilin rajon veç e veç ku vërejmë një shpërndarje të mirë balancuar të investimeve nëpër rajonet socio-ekonomike rajonale me diferenca të vogla prej 2% - 6% mes rajoneve sipas vlerës totale të financimit 980,057.00 € për pesë (5) rajonet zhvillimore.

Tabela 37. Paraqitja tabelare e shpërndarjes së mjeteve sipas pesë(5) rajoneve zhvillimore (MASA - 15, 2021)


TOTALI I VLERAVE TË FINANCIMIT DHE BASHKËFINANCIMIT SIPAS RAJONEVE EKONOMIKE - PRE MASA 15, 2021				
PESE (5) RAJONET SOCIO- EKONOMIKE	VLERA E FINANCIMIT- PRE-MASA 15	%	VLERA E BASHKËFINANCIMI T NGA BIZNESET	%
Rajoni Socio-Ekonomik Qendër	216,402.00 €	22%	44,313.06 €	20%
Rajoni Socio-Ekonomik Jug	198,310.00 €	20%	37,476.95 €	17%
Rajoni Socio- Ekonomik Perëndim	218,455.00 €	22%	51,960.70 €	24%
Rajoni Socio-Ekonomik Veri	156,700.00 €	16%	40,134.03 €	19%
Rajoni Socio –Ekonomik Lindje	190,190.00 €	19%	42,302.09 €	20%
Gjithsej	980,057.00 €	100%	216,186.83 €	100%
Gjithsej Financimi dhe Bashkëfinancimi	1,196,243.83€			

Ndërkaq në grafikonet e mëposhtëm kemi paraqitur shpërndarjen e mjeteve financiare sipas pesë rajone zhvillimore për vitin 2021 për programin “MASA-15”.

Grafiku 18. Paraqitja grafike e financimit dhe bashkëfinancimit nga MZHR në kuadër të Programit “Masa 15”, implementuar në v.2021



Grafiku 19,20. Paraqitja grafike në % e financimit dhe bashkëfinancimit nga MZHR në kuadër të Programit mbështetës “Masa 15”, implementuar në v.2021




Më poshtë kemi bërë edhe krahasimin e vlerës së financimit dhe numrit të projekteve përfituese sipas Loteve brenda programit “MASA-15”, 2021.


Tabela 38. Paraqitja tabelare e shpërndarjes së mjeteve financiare dhe numri i projekteve sipas pesë (5) rajoneve zhvillimore (MASA-15 2021)

VLERA E FINANCIMIT DHE NUMRI I PROJEKTEVE SIPAS LOTEVE PRE-MASA, 2021				
RAJONET SOCIO-EKONOMIKE	VLERA E FINANCIMIT (LOT 2)	VLERA E FINANCIMIT (LOT 3)	NUMRI I PROJEKTEVE (LOT 2)	NUMRI I PROJEKTEVE (LOT 3)
Rajoni Socio-Ekonomik Qendër	88,802.00 €	127,600.00 €	9	9
Rajoni Socio-Ekonomik Jug	55,520.00 €	142,790.00 €	6	10
Rajoni Socio-Ekonomik Perëndim	88,000.00 €	130,455.00 €	9	9
Rajoni Socio-Ekonomik Veri	40,000.00 €	116,700.00 €	4	8
Rajoni Socio- Ekonomik Lindje	86,390.00 €	103,800.00 €	9	7
Gjithesëj	358,712.00 €	621,345.00 €	37	43
Gjithesëj vlera e financimit dhe numri i projekteve	980,057.00 €		80	

Grafiku 21. Shuma e përgjithshme e financimit në programin “Pre- MASA 15”, sipas (Lot 2 dhe Lot 3) në pesë (5) Rajonet Zhvillimore në Kosovë




Grafiku 22. Numri i projekteve përfituese nga bizneset në programin “MASA 15”, sipas (Lot 2 dhe Lot 3) në pesë (5) Rajonet Zhvillimore në Kosovë




7.1 Shuma e përgjithshme e investimeve në (%) sipas sektorëve në kuadër të programit mbështetës “MASA-15 - 2021”

Ministria e Zhvillimit Rajonal çdo herë ka stimuluar sektorin e prodhimit përmes programeve që ka implemtuar në secilin rajon zhvillimor, duke ngritur kapacitet e tyre prodhuese përmes makinerive të reja dhe zgjerimin e kapaciteteve prodhuese për ti kontribuar sa më shumë eksportit dhe zvoglimit të importit. Konsideruar edhe grafikonet e mëposhtme dhe paraqitjen tabelare shohim se **38** projekte apo **48%** e përfituesëve janë mbështetur në sektorin e prodhimit dhe **42** projekte apo **52%** e përfituesëve janë mbështetur në sektorin e shërbimeve.

Grafiku 23. Paraqitja grafike në % e sektorëve përfitues sipas pesë (5) rajoneve zhvillimore në kuadër të programit mbështetës “Masa 15”



Grafiku 24. Paraqitja grafike e sektorëve përfitues sipas pesë (5) rajoneve zhvillimore në kuadër të programit mbështetës “Masa 15”



7.2 Paraqitja tabelare e shpërndarjes së projekteve sipas komuniteteve në rajone zhvillimore


Ministria e Zhvillimit Rajonal çdo herë mbetet e përkushtuar për të stimuluar komunitetet pakicë që të aplikojnë sa më shumë në programet mbështetëse të MZHR-së, përmes sesioneve informuese dhe udhëzimeve tjera që aplikon Departamenti për Zhvillim Rajonal me bizneset në përgjithësi. Nga paraqitja tabelare e mëposhtme ku janë paraqitur numri i përfituesve sipas përkatësisë etnike vërejmë që ka komunitete të cilat nuk kanë përfituar nga ky program mbështetës sikurse komuniteti boshnjak, goran si dhe ai rom, ashkali dhe egjiptas. Nga ky

program përfituesit më të shumtë në numër janë komuniteti shqiptar si komuniteti më i madh, pastaj komuniteti turk me pesë projekte dhe një projekt nga komuniteti serb.

Tabela 39, Paraqitja tabelare e shpërndarjes së mjeteve sipas përkatësisë etnike në pesë(5) rajoneve zhvillimore (MASA 15- 2021)

Programi për Rimëkëmbje Ekonomike - MASA 15 (Lot2 dhe Lot3)								
Pesë(5) Rajonet Zhvillimore	Përkatësia Etnike							Gjithsej numri i përfituesëve
	Viti	Shqiptar	Serb	Boshnjak	Turk	Goran	Rom, AshkaliE gjiptas	
	2021	74	1	0	5	0	0	80
Gjithsej numri i përfituesëve	80							

Grafiku 25. Paraqitja grafike shpërndarjes së projekteve sipas përkatësisë etnike Programi për Rimëkëmbje Ekonomike - MASA 15



7.3. Projektet përfituese nga gratë për vitin 2021, programi “PRE-MASA-15”

Në Programin për Rimëkëmbje Ekonomike kemi (11) njëmbëdhjetë biznese përfituese të udhëhequra nga gratë dhe (69) gjashtëdhjetë e nëntë biznese të udhëhequra nga burrat, Ndërkaq numri më i madh i projekteve të financuara për gratë është në Rajonin Zhvillimor Veri, me gjithsej (4) katër projekte përfituese. Sipas tabelës mëposhtë nga Rajoni Zhvillimor Perëndim nuk kemi asnjë përfituese grua dhe në total përqindja dalluese mes bizneseve të udhëhequr nga burrat kundrejt atyre nga gratë mbetet shumë e lartë me një përqindje prej 14% gra përfituese dhe 86% biznese të udhëhequr nga burrat .


7.3.1 Shpërndarja tabelare e projekteve përfituese të udhëhequra nga gratë në pesë (5) rajone zhvillimore në Kosovë

Tabela 40, Paraqitja tabelare e shpërndarjes së mjeteve të projekteve të udhëhequra nga gratë në pesë (5) rajone zhvillimore (Masa- 15, 2021)

PESE (5) RAJONET ZHVILLIMORE	NUMRI I PËRGJITHSHËM I PROJEKTEVE
Rajoni socio Ekonomik Qendër	3
Rajoni Socio-Ekonomik Jug	2
Rajoni socio- Ekonomik Perëndim	0
Rajoni Socio-Ekonomik Veri	4
Rajoni Socio –Ekonomik Lindje	2
GJITHSEJ:	11

7.3.2 Paraqitja grafike në % e shpërndarjes së njëmbëdhjetë (11) projekteve të udhëhequra nga grate në pesë (5) rajonet zhvillimore në Kosovë

Grafiku 26 dhe 27, Shpërndarja e përgjithëshme e projekteve të udhëhequra në baza gjinore në % si dhe sipas pesë (5) rajoneve zhvillimore (Masa-15 2021)



VIII. Përfundime dhe rekomandime

Viti 2021 është viti i katërt që Ministria e Zhvillimit Rajonal implementon programin për përkrahje të bizneseve, “Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB)”, si dhe për herë të dytë, “Programin për Rimëkëmbje Ekonomike 2021, Masa 15”, program ky i cili ka derivuar nga Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2020-2023 i aprovuar në Qeveri. Me miratimin e Ligjit për Buxhetin 2021, është krijuar program i veçantë, Programi për Rimëkëmbje Ekonomike, ku janë alokuar mjetet që janë dedikuar për qëllime të mbështetjes ekonomike dhe sociale për të tejkaluar sfidat e pandemisë. Ministria e Zhvillimit Rajonal është përcaktuar përgjegjëse për zbatimin e Masës 15, për “Mbështetjen e programve ekzistuese që lidhen me zhvillimin rajonal e që ndikojnë në zhvillimin rajonal të balancuar”.

Konsiderojmë që implementimi i dy programeve ka kaluar me sukses sfidat dhe kufizimet e shkatuara si pasojë e Pandemisë Covid 19, vit i cili ka ballafaquar bizneset me shumë humbje deri në mbyllje të bizneseve si pasojë e kufizimeve të veprimtarive të tyre dhe levizjes së lirë, që ka shkatuar rënie drastike të veprimtarive afariste dhe mbyllje të industrive dhe rritje të papunsisë.

Vlenë të përmendet se para shpërthimit të pandemisë Covid-19, parashikimet për ekonominë e Kosovës për vitin 2020 ishin premtuese. Vlerësimet e bëra nga Grupi i Bankës Botërore (GBB), parashihnin rritje prej 4% të Bruto Produktit Vendor (BPV) për vitin 2020. Nga Administrata Tatimore e Kosovës është konfirmuar se bizneset deri më datën 31.12.2020 kanë pasur qarkullim rreth 1.2 miliard Euro më pak, ndërsa që rreth 50 milion Euro nuk janë inkasuar nga ATK si rezultat i mos realizimit të qarkullimit nga ana e bizneseve. Poashtu, nga Dogana e Kosovës është konfirmuar se si pasojë e rënies së konsumit, ka pasur rënie të importit dhe një rritje të lehtë të eksportit. Përderisa aktualisht Banka Qendrore e Kosovës në konferencën e fundvitit lidhur me stabilitetin ekonomik në vend ka theksuar se ekonomia e vendit ka pësuar rënie për 7.2 %⁷. Sektorët më të dëmtuar sipas këtij hulumtimi rezultojnë të jenë gastronomia me 66.4%, tregtia me shumicë 9.3%, tregtia me pakicë 7.5%, prodhimi me 15.6% , ndërsa të tjerat përbëjnë 0.9%.⁸

Mbi 59.6% e bizneseve janë mbyllur për 3 muaj, 43.6% deklaruan se kanë ulur numrin e punëtorëve nga një deri në pesë punëtorë, 71.6% kanë deklaruar se nuk kanë rritur numrin e të

⁷ <http://odaefarizmit.org/wp-content/uploads/2021/04/Hulumtim-Oda-e-Afarizimit-te-Kosoves-OAK-4.pdf>

⁸ <http://odaefarizmit.org/wp-content/uploads/2021/04/Hulumtim-Oda-e-Afarizimit-te-Kosoves-OAK-4.pdf>

punësuarve, 28.4% kanë deklaruar se të ardhurat e tyre kanë rënë mbi 50% ndërsa vetëm 13.6% deklaruan se të ardhurat e tyre nuk janë ulur gjatë kësaj kohe kurse 70.1% deklaruan se të ardhurat e tyre nuk u rritën krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.⁹ Nga programet që ka implementuar MZHR, shërbimet kanë pasë rritje më të madhe në krahasim me veprimtarinë e prodhimit. Në kuadër të programit PZHRB (2021) vërehet një diferencë e shtuar mes sektorëve ku bizneset përfituese të sektorit të shërbimeve janë 73%, ndërsa 27 % i takojnë sektorit të prodhimit. Këtë diferencë mes sektorëve e ka ndikuar nr. më i madh i aplikuesve më të rinj në kuadër të Lot1 Start Up që ka mbështetur PZHRB ku është vërejtur që kjo moshë është më shumë e fokusuar në sektorin e shërbimeve duke i vënë theks fushës së IT-së.

Masa 15 nga totali i 80 projekteve përfituese, 52% janë biznese që në veprimtarinë e tyre kane shërbimet ,ndërsa 48% janë të sektorit prodhim. Ky rezultat përkon edhe me Lotet që ka mbështet Masa 15 të cilat kanë qenë biznese me qarkullim më të madh prandaj prodhimi dhe shërbimet janë më të përafërta.

Ministria e Zhvillimi Rajonal ka realizuar një punë dhe një qasje konstruktive dhe profesionale ndaj të gjithë aplikuesëve dhe përfituesve duke realizuar video informuese vizuele me përfituesit si dhe monitorim online të bizneseve sipas procedurave monitoruese që aplikon MZHR. Realizimi i sesioneve informuese për secilin rajon, për sqarimin e programeve dhe procedurave të aplikimit, ofrimit të përgjigjeve përmes web-faqes në pyetjet e parashtuara nga aplikantët gjatë procesit të aplikimit, si dhe publikimit në web faqe të udhëzuesve ku kanë qenë te specifikuar në detaje të gjitha kushtet dhe kriteret e përkrahjes së bizneseve dhe ndërmarrësve të rinjë nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar “PZHRB-2021” dhe “MASA-15”.

Implementimi i këtyre programeve në shumë prej **(1,376,278.62) euro**, përmes përkrahjes së bizneseve të reja me potencial rritje dhe mbështetjes së bizneseve egzistuese, me numër prej 422 të punësuar të rinjë duke ndikuar kështu në uljen e papunësisë. Përkrahja e bizneseve që kontribuojnë në zëvendësimin e importeve dhe stimulimin e eksportit të produkteve vendore, stimulimin e ideve inovative ka ndikuar pozitivisht edhe në mirëqenjen e përgjithshme të qytetarëve gjatë periudhës sfiduese pandemike me të cilën janë ballafaquar gjitha bizneset. Është inkurajues fakti se nga 164 projekte në total, 44 projekte udhëhiqen nga gratë ku e dimë që bizneset e udhëhequra nga gratë janë goditur rëndë nga pandemia dhe aplikimi i masave nga Qeverisë së Kosovës. Sa i përket veprimtarive të përfshira në dy programet PZHRB dhe Masa 15, Programi për Rimëkëmbje Ekonomike Masa - 15, konsideruar Lotet që ka mbështetur dhe

9 Hulumtimi OEK

shumat e financimit ka realizuar numrin më të madh të të punsuarve të rinjë, prej 275 personave. Rajoni në të cilin më së shumti kanë përfituar gratë, është Rajoni Zhvillimor Qendër (Prishtina me komunat përreth). Çka duhet të kushtohet më tepër rëndësi, është stimulimi i aplikimit të përfituesve nga komunitetet jo shumicë ku sfida e mos aplikimit nga komunitetet pakicë është një sfidë në të cilën duhet të punohet dhe të stimulohen sa më shumë komunitete nga secili rajon zhvillimor për të përfituar nga skemat apo programet që implementon MZHR.

Me funksionalizimin e sistemit E-kosova dhe aplikimin online Ministria e Zhvillimit Rajonal ka arritur avancim në: ekonomizimin dhe efektshmërinë në kohës gjatë procesit të aplikimit, avancimim e nivelit të aplikimit, të rrit transparencën dhe llogaridhënjën në raport me aplikantët dhe përshpejtimin e procesit të vlerësimit. Gjithashtu duhet të theksohet që kemi një kërkesë të madhe me një numër të madh të aplikimeve në *Lot 1(Start Up)* të mbështetur në kuadër të PZHRB-së ku është pranuar edhe numri më i madh i aplikimeve prej 850 aplikimesh nga pesë rajonet zhvillimore, me një diferencë të madhe në kërkesë në krahasim me Lotet tjera. Përkushtim edhe më i madh kërkohet nga MZHR për të stimuluar këtë kategori duke mundësuar kështu përkrahjen ideve të reja tek bizneset fillestare e që përfaqësohen kryesisht nga moshat e reja.

Ministria e Zhvillimit Rajonal i ka kushtuar rëndësi dhe përkushtim të madh krijimit të mundësive me donatorë të ndryshëm vendor dhe ndërkombëtar, në dhënjën e mundësisë së ngritjes të kapaciteteve të të interesuarve për aplikim dhe implementim të projekteve, realizimin e trajnimve online me BERZH për ngritjen e kapaciteteve të menaxhimit dhe aspekteve tjera financiare me përfituesit e programeve si dhe anagzhimin e praktikantëve si rrejdhojë e bashkëpunimit me UNICEF dhe OSBE si dhe bashkëpunimet tjera me Odat e ndryshme Ekonomike që operojnë në Republikën e Kosovës.

IX. Burimet e informacionit:

- Raporti i Komsionit të Vlerësimit (PZHRB) 2021, protokoluar me datë:18.05.2021 dhe Nr.protokoli:490
- Raporti i Komsionit të Vlerësimit (PRE-MASA15) 2021, protokoluar me datë:18.05.2021 dhe Nr.protokoli:491
- Bazuar në Raportin Financiar Vjetor të protokolluar me datë: 31.01.2022 dhe nr. Protokolli: 29
- Udhëzimi Administrativ (MZHR) nr: 01/2018 i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ 02/2018 për kushtet dhe kriteret e përkrahjes së bizneseve dhe ndërmarrësve të rinjë nga Programi për Zhvillim Rajonal të balancuar “PZHRB” dhe “PRE-MASA 15”.
- <https://mzhr.rks-gov.net/publikimet/>
- Raporti nga MINT
- Raporti nga MBPZHR